

VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË
PLUS NETWORK sh.p.k

Sot, më datë 21 Prill 2020 në orën 11:00 pranë selisë ligjore të Shoqërisë PLUS NETWORK Sh.p.k, Rr. Aleksander Moisiu, ish Kinostudio, Tiranë, Shqipëri (këtej e tutje “Shoqëria”) u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë ku janë të pranishëm ortakët si në vijim:

Towers Network Albania Sh.A, me seli në Rr. Aleksandër Moisiu, ish Kinostudio, Tiranë, Shqipëri, e përfaqësuar nga përfaqësuesi i saj ligjor, Z. Artan Xhori, shtetas shqiptar, lindur Vlorë më 16 Tetor 1963.

Duke qenë se është i pranishëm ortaku që përfaqëson 100% të kapitalit të Shoqërisë, mbledhja e Asamblesë së ortakëve të Shoqërisë është e vlefshme, e rregullt dhe e aftë për të vendosur mbi Rendin e Ditës si më poshtë vijon:

Rendi i ditës:

1. ZVOGËLIM I KAPITALIT
2. TË NDRYSHME

1. ZVOGËLIMI I KAPITALIT.

Në lidhje me pikën e parë të Rendit të Ditës, në përputhje me nenin 7.1 dhe 10.3 të Statutit, Asambleja në unanimitet,

VENDOS:

Të zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë me një vlerë prej 1,308,582,000 Lekë (një miliardë e treqind e tetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë) lekë.

2. TË NDRYSHME

Të autorizojë Zj. Eglantina Lamaj, në cilësinë e Administratorit të shoqërisë PLUS NETWORK sh.p.k, të kryejë të gjithë veprimet e nevojshme për depozitim të këtij vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe çdo autoritet tjetër ku ky vendim duhet të depozitohet.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij nga përfaqësuesi i Ortakut të Vetëm.

Ortaku i Vetëm “TOWERS NETWORK ALBANIA” Sh.A përfaqësuar nga Administratori

Z. Artan XHORI

TOWERS NETWORK ALBANIASH.A
NIPT L42222001F
Rr. Aleksandër Moisiu, ish Kinostudio

VENDIM
I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË
TOWERS NETWORK ALBANIASH.A

Sot, më datë 21 Prill 2020 në orën 10:00 pranë selisë ligjore të Shoqërisë TOWERS NETWORK ALBANIA SH.A, Rr. Aleksander Moisiu, ish Kinostudio, Tiranë, Shqipëri (këtej e tutje "Shoqëria") u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë ku janë të pranishëm ortakët si në vijim:

1. **TV KLAN SHA**, zotërues i 75% të kapitalit aksionar të regjistruar të Shoqërisë TOWERS NETWORK ALBANIA SHA, përfaqësuar nga aksionarët e saj personalisht në mbledhje, Z. Aleksandër Frangaj, zotërues i 60% të kapitalit dhe Znj. Alba Gina zotëruese e 40% të kapitalit aksionar të shoqërisë.
2. **Z. Artan XHORI**, zotërues i 25% të kapitalit aksionar të regjistruar të Shoqërisë TOWERS NETWORK ALBANIA SHA, pjesëmarrës personalisht në mbledhje

Duke qenë se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë 100% të kapitalit të Shoqërisë, mbledhja e Asamblesë së ortakëve të Shoqërisë është e vlefshme, e rregullt dhe e aftë për të vendosura më poshtë vijon:

1. **Autorizimi** i Z. Artan XHORI në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë TOWERS NETWORK ALBANIA SHA, të përfaqësojë dhe të marrë vendimet e mëposhtme:
 - i. Të miratojë zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë së kontrolluar **Plus Network sh.p.k** me NIPT L42404007P, në vlerën 1,308,582,000 Lekë (një miliardë e treqind e tetë milion e pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë) si pasojë e Credit Note, fatura numër 197411756 datë 27.02.2018, e pranuar dhe deklaruar për efekt të regjistrimit në kapital.

ORTAKËT

Z. Artan XHORI

Për TV KLAN SHA

Z. Aleksandër FRANGAJ

Znj. Alba GINA

